



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1419/Prot
19

Datë 26 / 7 2022

VENDIM

Nr. 34 , Datë 26. 07. 2022


PËR

“MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV” NË “NEGOCIATAT DHE ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN, NË INSTITUTIN E STUDIMEVE EVROPIANE-UT, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 ”.

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Statutin e UT-së, miratuar nga MASR –së me urdhërin Nr 816 datë 26,12,2018 ; Udhëzimit të MASR-së Nr.1 datë 14,01,2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”; Udhëzimit të MASR-së Nr. 10 datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose çertifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave” si dhe Vendimit të Senatit Akademik të UT-së Nr. 12, datë 20.07.2022 dërguar nga Rektori i UT-së me shkresën Nr. 1419/8 datë 25.07.2022. “Mbi miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në “Negociatat dhe Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, në Institutin e Studimeve Evropiane-UT, për vitin akademik 2022-2023”, Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në “Negociatat dhe Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, në Institutin e Studimeve Evropiane-UT, për vitin akademik 2022-2023”
2. Burimi i financimit për këtë program studimi do të jetë tarifa e shkollimit për program, dhe pa efekte financiare shtesë nga Buxheti i UT-së.



Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Rektorati i UT-së Tiranë